



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KESHILLI



Nr. 1446 / prot  
9

Koplik më: 28/06 /2022

VENDIM

Nr 20, Datë 27 / 06 / 2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/NË PËRDORIM TË SIPERFAQËS PYJORE PER**  
**NDERTIMIN E HEC-eve“ KOZHNJE 1 DHË KOZHNJE 2 TAMARË NGA SHOQERIA**  
**“TAMARA HYDRO ENERGY ”SH.P.K DHË HEQJEN NGA FONDI PYJOR I SIPËRFAQES 4.53**  
**HA QË BËJNË PJESE NË EKONOMINË PYJORE KULLOSORE“ VUKEL-NIKC”.**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 27.06.2022 , në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika “e”, ligjin nr.57/2020“ Për Pyjet ”, si dhe VKM nr.591 , datë 09.10.2018“ Për disa ndryshime në vendimin Nr.1353, datë 10.10.2008 , “ Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës , mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, VKM nr.592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 1374, datë 10.10.2008,“ Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave , që ndiqen për heqjen , shtimin dhe ndryshimin e destinacioni të fondit kullor”, të ndryshuar, Udhëzimi e Ministrit Të Mjedisit nr.1 , dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”. VKM nr. 391 dt.21.06.2006 te Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” si dhe bazuar në VKM. Nr.433, datë 08.06.2016 , të Këshillit të Ministrave , “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive “, të ndryshuar.

**VENDOSI:**

1. Dhënie me qira /në përdorim të sipërfaqes pyjore 17.54 ha që shtrihen në ngastrat sipas tabelës bashkangjitur raportin mbi studimin tekniko ekonomik të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, për një afat 10 (dhjetë) vjeçar.
2. Vlera totale e dhënies me qira në vit është 1 857 833 (një milion tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tri dhjetë e tre) lekë.



3. Vlerën e investimeve që do të kryhen (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime, etj.) për sipërfaqen që do të zëvendësoj sipërfaqen e hequr nga fondi pyjor e kullosor për 0.88 Ha = 1 032680 lekë.
4. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore",

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratur me 27.06.2022

Vota Pro 24

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 2

Zbardhur me datë 28.06.2022

